



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:067894

Datë: 15.10.2021

Numri i dokumentit: 02284556

A.nr.1029/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Anita Nikçi-Morina dhe me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Ardian Maxhuni, në konfliktin administrativ të paditëses, A.Q nga F.K, rruga “Sh.K”, H./..., numër ..., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit E.O, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK), me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i aktit administrativ – njoftim Nr. ref. A.nr.51/2020 e datës 15.05.2020, jashtë seancës gjyqësore, me datën 15.10.2021, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditëses A.Q nga Fushë Kosova, si e BAZUAR.

II. ANULOHET akti administrativ - njoftimi i të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK) me seli në Prishtinë Nr. ref. A.nr.51/2020 e datës 15.05.2020 dhe detyrohet e paditura që paditëses në afat prej *tridhjetë* (30) ditësh me vendim të vendosë lidhur me ankesën e paditësit të datës 25.02.2020 dhe të njëjtën t’ia dorëzojë palëve sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

A r s y e t i m

Paditëja A.Q nga F.K përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka parashtruar padi në këtë gjykatë më datën 12.06.2020, kundër të paditurës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës, me bazë juridike, anulimin e aktit administrativ - njoftim ref. A.nr.51/2020 e datës 15.05.2020 .

Gjykata shqyrtoi aktin administrativ – njoftimin sipas A.nr.172/2020 e datës 03.08.2020 të goditur me padi, në përputhje me nenin 35 i Ligjit për Konfliktet Administrative, i cili përcakton se:

“Nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë në bazë të paragrafit 2. të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji, kurse konstaton se akti administrativ i kontestuar përmban të meta esenciale, që e pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit, e anulon me aktgjykim, aktin administrativ edhe pa e dërguar padinë në përgjigjen”.

Po ashtu edhe në bazë të nenit 44.2 të njëjtit ligj i cili përcakton se:

“Për nulitetin e aktit administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare”.

Nga akti administrativ i kundërshtuar, gjykata vëren se e paditura për shkak të rrethanave të cilat kanë pamundësuar nxjerrjen e vendimit siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke iu përgjigjur ankesës së paditësit, ka lëshuar aktin administrativ – Njoftimin ref. A.nr.51/2020 e datës 15.05.2020. Paditësi i pakënaqur me këtë akt administrativ ka parashtruar padi në këtë gjykatë, duke e kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit akt administrativ – Njoftimin ref. A.nr.51/2020 e datës 15.05.2020.

Gjykata shqyrtoi kërkesëpadinë e paditësit dhe vlerësoi se në raport me këtë akt administrativ konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet sipas dispozitave të Ligjit (Nr. 03/L-202) për Konfliktin Administrative .

Në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, akti administrativ – njoftimin me nr. ref. A.nr.51/2020 e datës 15.05.2020 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, paraqet vendim administrativ të formës së prerë dhe i njëjti është i ekzekutueshëm.

Duke marr parasysh faktin se tani kanë pushuar shkaqet të cilat kanë pamundësuar të paditurën për vendosjen e çështjes dhe duke marr parasysh se çështja e vendosjes nga ana e të paditurës

përbën çështje paraprake për vendosje në mënyrë meritore sipas padisë së paditëses, gjykata vendosi që çështjen ta kthejë tek e paditura për vendosje sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Të metat e cekura më lartë, janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligshmërisë së aktit të kundërshtuar, ndërsa rrethanat e reja të krijuara tek e paditura mundësojnë zhvillimin e rregullt të procedurës administrative, prandaj në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, në kuptim të dispozitave ligjore nga neni 65 i Ligjit për Konfliktet Administrative, që në afat prej 30 ditësh, në ri - procedurë të veprj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të marr aktvendim të drejtë, e të bazuar në ligj, me të cilin do të njoftohen palët me kohë .

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lart, gjykata në kuptim të neneve 5, 35, lidhur me nenin 44.2, dhe 46 par. 3 i Ligjit për konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.1029/2020 datë 15.10.2021

G j y q t a r j a
Anita Nikçi-Morina

KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej (15) ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.